Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

# Statistikat e karakteristikave të mjeteve rrugore

## Viti 2022 *

**Tiranë, më 21 Korrik 2023**: Botimi "Karakteristikat e mjeteve rrugore" jep informacion mbi numrin e mjeteve rrugore që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me status "Aktiv" ose "Të çregjistruara përkohësisht" në Regjistrin Kombëtar Shqiptar të mjeteve rrugore.

Në vitin 2022, numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe "të çregjistruar përkohësisht" rezulton 796.438 mjete, nga 740.669 mjete të regjistruara deri në vitin 2021, duke u rritur me 7,5 %.

### Mjete rrugore sipas llojit

Nga mjetet rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë "Autoveturat" (80,3 %), "Automjetet për për transport të përzier " (6,5 %) dhe "Motor" (5,4 %), (Tab.1).

Në vitin 2022, numri i autoveturave për pasagjerë për 1.000 banorë është 232. Në vitin 2021, ky tregues ishte 212 autovetura për 1.000 banorë.

Tab. 1 Mjetet rrugore sipas llojit, 2021 - 2022

| Lloji i mjetit rrugor | 2021 | 2022 | 2022/2021 % |
|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | **740.669** | **796.438** | 7,5 |
| Autoveturë | 593.280 | 639.379 | 7,8 |
| Automjet për transport të përzier | 49.596 | 51.674 | 4,2 |
| Motor | 37.931 | 42.732 | 12,7 |
| Kamion | 14.404 | 14.957 | 3,8 |
| Autobus | 7.867 | 8.211 | 4,4 |
| Automjet për transport të veçantë | 7.411 | 7.926 | 6,9 |
| Ciklomotor | 6.436 | 6.354 | -1,3 |
| Gjysëm rimorkio | 6.759 | 7.143 | 5,7 |
| Tërheqës | 5.138 | 5.530 | 7,6 |
| Automjet për përdorim të veçantë | 3.977 | 4.291 | 7,9 |
| Makinë bujqësore | 1.673 | 1.549 | -7,4 |
| Rimorkio për transport mallrash | 1.659 | 1.776 | 7,1 |
| Makinë teknologjike | 819 | 788 | -3,8 |
| Motokarro | 808 | 807 | -0,1 |
| Rimorkio për transport të veçantë | 681 | 772 | 13,4 |
| Kategori të tjera | 2.230 | 2.549 | 14,3 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

**Për publikim 21/07/2023**

*Të dhënat i referohen mjeteve rrugore të regjistruara deri në vitin 2022

Gjatë vitit 2022, numri i autoveturave është rritur me 7,8 %, automjetet për përdorim të veçantë me 7,9 % dhe automjetet për transport të veçantë janë rritur me 6,9 % krahasuar me vitin 2021.

## Mjetet rrugore sipas qarqeve

Në vitin 2022, numri i autoveturave për pasagjerë për 1.000 banorë në qarkun Durrës është 301, i ndjekur nga qarku Lezhë me 287 autovetura për 1.000 banorë. Qarku me numrin më të vogël të autoveturave për pasagjerë për 1.000 banorë është qarku Korçë me 165 autovetura për 1.000 banorë.

### Tab. 2 Mjete rrugore sipas qarqeve, 2022

| Qarku | Mjete rrugore | Autovetura | Autobus | Kamion |
|---|---|---|---|---|
| **Shqipëria** | **796.438** | **639.379** | **8.211** | **14.957** |
| Berat | 32.489 | 23.676 | 385 | 784 |
| Dibër | 21.967 | 18.697 | 292 | 574 |
| Durrës | 106.330 | 87.326 | 1.075 | 1.773 |
| Elbasan | 54.960 | 43.750 | 616 | 1.126 |
| Fier | 74.294 | 58.101 | 689 | 1.510 |
| Gjirokastër | 17.655 | 13.996 | 214 | 545 |
| Korçë | 39.863 | 31.763 | 426 | 959 |
| Kukës | 18.517 | 15.995 | 181 | 484 |
| Lezhë | 39.606 | 32.809 | 377 | 810 |
| Shkodër | 57.339 | 45.636 | 559 | 978 |
| Tiranë | 277.082 | 222.871 | 2.756 | 4.382 |
| Vlorë | 56.336 | 44.759 | 641 | 1.032 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

## Mjetet rrugore sipas kambios

Autoveturat me kambio “Manuale” zënë pjesën më të madhe (60,8 %) të autoveturave gjithsej që rezultojnë me status “aktiv” ose “të çrregjistruara përkohësisht” në vitin 2022.

### Tab. 3 Mjete rrugore sipas kambios, 2022

| Loji i kambios | Autovetura | Autobus | Kamion |
|---|---|---|---|
| Manuale | 388.516 | 6.702 | 13.998 |
| Automatike | 244.332 | 1.368 | 752 |
| Semi-Automatike | 5.878 | 123 | 117 |
| E papërcaktuar | 653 | 18 | 90 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

*Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3*

## Mjetet rrugore sipas vitit të prodhimit

Numri i autoveturave të regjistruara në vitin 2022, me vit prodhimi 2011-2022 është rritur me 27,1 %, grupi 2000-2010 është rritur me 7,7 % ndërsa grupi i autoveturave me vit prodhim para vitit 2000 ka pësuar rënie me 0,8 %.

### Tab. 4 Autovetura të grupuara sipas viteve të prodhimit, 2021-2022

| Viti i prodhimit | 2021 | 2022 | 2022/2021 % |
|---|---|---|---|
| <2000 | 137.250 | 136.095 | -0,8 |
| 2000-2010 | 393.477 | 423.783 | 7,7 |
| 2011-2022 | 62.553 | 79.501 | 27,1 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

Në nivel më të detajuar, në vitin 2022, autoveturat me moshë 11-20 vite përbëjnë 51,1 % të numrit gjithsej të autoveturave me status “aktiv” ose “të çrregjistruara përkohësisht”.

### Tab. 5 Mjete rrugore të grupuara sipas moshës, 2022

| Mosha | Autovetura | Autobus | Kamion |
|---|---|---|---|
| 0-2 vite | 4.998 | 23 | 71 |
| 3-5 vite | 10.674 | 42 | 142 |
| 6-10 vite | 35.371 | 254 | 351 |
| 11-20 vite | 326.638 | 3.291 | 3.132 |
| > 20 vite | 261.698 | 4.601 | 11.261 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

## Mjete rrugore sipas markës

Ndër markat kryesore të autoveturave që qarkullojnë në vend, dominojnë marka “Mercedez Benz” (18,2 %), e ndjekur nga “Volkswagen” (18,0 %) dhe “Daimler Chrysler” (10,5 %).

### Tab. 6 Mjete rrugore sipas markës, 2022

| Marka | Autoveturë | Marka | Autobus | Marka | Kamion |
|---|---|---|---|---|---|
| MERCEDES BENZ | 116.204 | MERCEDES BENZ | 3.587 | MERCEDES BENZ | 7.614 |
| VOLKSWAGEN | 115.064 | DAIMLER CHRYSLER | 665 | MAN | 1.543 |
| DAIMLER CHRYSLER | 66.859 | FORD | 456 | DAIMLER CHRYSLER | 986 |
| FORD | 61.075 | IVECO FIAT | 411 | IVECO FIAT | 835 |
| OPEL | 33.078 | MAN | 320 | IVECO MAGIRUS | 718 |
| AUDI | 36.868 | RENAULT | 252 | VOLVO | 605 |
| FIAT | 24.626 | SETRA | 237 | DAIMLER BENZ | 509 |
| TOYOTA | 29.696 | VOLKSWAGEN | 223 | SCANIA | 336 |
| BMW | 21.631 | IVECO | 261 | DAF | 310 |
| RENAULT | 16.556 | SCANIA | 208 | RENAULT | 292 |
| TË TJERA | 117.722 | TË TJERA | 1.591 | TË TJERA | 1.209 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

*Për t’u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: [http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3](http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3)*

Në vitin 2022, marka “Mercedez Benz” regjistrohet si marka më e përdorur e autoveturave të regjistruara me vit prodhimi para 2000 dhe viteve 2011-2022. Marka “Volkswagen” regjistrohet si marka më e përhapur e autoveturave me vit prodhimi 2000-2010.

**Tab. 7 Autovetura sipas markës dhe viteve të prodhimit, 2022**

| <2000 | % | 2000-2010 | % | 2011-2022 | % |
|---|---|---|---|---|---|
| MERCEDES BENZ | 35,4 | VOLKSWAGEN | 18,5 | MERCEDES BENZ | 21,2 |
| VOLKSWAGEN | 17,6 | DAIMLER CHRYSLER | 14,3 | VOLKSWAGEN | 16,3 |
| FORD | 7,4 | MERCEDES BENZ | 12,1 | AUDI | 10,0 |
| OPEL | 5,6 | FORD | 10,9 | FORD | 6,0 |
| DAIMLER CHRYSLER | 4,4 | OPEL | 5,5 | HYUNDAI | 5,9 |
| AUDI | 4,0 | AUDI | 5,5 | SKODA | 4,3 |
| FIAT | 3,7 | TOYOTA | 5,9 | BMW | 5,1 |
| RENAULT | 3,0 | FIAT | 4,0 | LAND ROVER | 4,3 |
| DAIMLER BENZ | 2,8 | BMW | 3,4 | TOYOTA | 3,3 |
| BMW | 2,3 | RENAULT | 2,7 | FIAT | 3,0 |
| TË TJERA | 13,8 | TË TJERA | 17,1 | TË TJERA | 20,5 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

**Mjete rrugore sipas lëndës djegëse**

Numri më i madh i autoveturave që qarkullojnë në vendin tonë në vitin 2022 përdorin lëndë djegëse “Naftë” duke zënë 73,7 % nga 73,6 % në vitin 2021, ndjekur nga autoveturat që përdorin lëndë djegëse “Benzinë” me 16,7 % ndaj numrit gjithsej të autoveturave nga 17,3 % që ky grup zinte deri në vitin 2021. Numri i autoveturave që përdorin lëndë djegëse “Naftë” në vitin 2022, është rritur me 7,8 % në krahasim me vitin 2021. Numri i autoveturave që përdorin lëndë djegëse “Benzinë” është rritur me 4,5 % krahasuar me vitin 2021.

**Tab. 8 Autovetura sipas lëndës djegëse, 2021 - 2022**

| Treguesi | Nr. Autovetura 2021 | Nr. Autovetura 2022 | 2022/2021% |
|---|---|---|---|
| Naftë | 436.756 | 470.930 | 7,8 |
| Benzinë | 102.432 | 107.010 | 4,5 |
| Benzinë + Gaz | 51.776 | 57.569 | 11,2 |
| Benzinë + Elektrik | 901 | 1.236 | 37,2 |
| Elektrik | 624 | 1.245 | 99,5 |
| Gaz | 339 | 396 | 16,8 |
| Naftë + Elektrik | 246 | 439 | 78,5 |
| Të tjera hybride | 206 | 554 | 168,9 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

*Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: [http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3](http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3)*

Numri i autobusëve të regjistruar në vitin 2022, që kanë përdorur lëndë djegëse “Naftë” është rritur me 4,2 % krahasuar me vitin 2021.

### Tab. 9 Autobusë sipas lëndës djegëse, 2021 - 2022

| Lënda djegëse | Autobus 2021 | Autobus 2022 | 2022/2021 % |
|---|---|---|---|
| **Autobusë Gjithsej** | **7.867** | **8.211** | **4,4** |
| Naftë | 7.812 | 8.144 | 4,2 |
| Benzinë | 6 | 7 | 16,7 |
| Benzinë + Gaz | 16 | 18 | 12,5 |
| Naftë + Elektrik | 22 | 31 | 40,9 |
| Gaz | 11 | 11 | 0,0 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

### Autovetura sipas vëllimit të motorik

Numri i autoveturave të regjistruara në vitin 2022 sipas vëllimit motorik >3000 cc është rritur me 10,4 %, numri i autoveturave me vëllim motorik <=2000 cc është rritur me 7,9 % dhe me vëllim motorrik 2001-3000 cc është rritur me 7,4 % krahasuar me të njëtën periudhë të një viti më parë.

### Tab. 10 Autovetura sipas vëllimit, 2021 - 2022

| Vëllimi motorik | 2021 | 2022 | 2022/2021 % |
|---|---|---|---|
| <=2000 | 398.785 | 430.103 | 7,9 |
| 2001-3000 | 179.297 | 192.496 | 7,4 |
| >3000 | 15.198 | 16.780 | 10,4 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

Vëllimi më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse “Naftë” është 1400 cc-1999 cc duke zënë 53,6 % gjithsej me lëndë djegëse naftë.

Vëllimi më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse “Benzinë”, është nën 1399 cc duke zënë 60,7 % të autoveturave gjithsej me lëndë djegëse benzinë.

### Tab. 11 Autovetura sipas lëndës djegëse dhe vëllimit, 2022

| Vëllimi | Autovetura me Naftë | Autovetura me Benzinë |
|---|---|---|
| **Autovetura Gjithsej** | **470.930** | **107.010** |
| <1399cc | 33.888 | 64.907 |
| 1400cc-1999cc | 252.559 | 29.993 |
| >2000cc | 184.483 | 12.110 |

***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT*

*Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3*

# Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është paraqitja e treguesve mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor në nivel sa më të detajuar si: mjetet rrugore sipas llojit, mjete rrugore sipas qarqeve, mjete rrugore sipas kambios, mjete rrugore sipas markës, mjete rrugore sipas lëndës djegëse, autoveturat sipas vitit të prodhimit dhe autoveturat sipas vëllimit motorik.

Në detajimin e autoveturave sipas lëndës djegëse, në grupin "të tjera hybride" janë përfshirë kategoritë "Benzinë + Gaz + Elektrike", "Benzinë + Elektrik + Hybrid", "Naftë + Gaz", "Naftë + Elektrik + Hybrid".

**Përkufizime**

**Automjete për transport të përzier** (ATP) **-** përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrikea me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

**Automjete për përdorim të veçantë** (APV) **-** mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

**Automjete për transport të veçantë** (ATV) **-** mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

**Kamion -** mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave**.**

**CC-** njësia matëse e vëllimit motorik të mjeteve rrugore e shprehur në centimetra në kub.

**Autoveturë -** mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

**Autobus** - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

**Ciklomotor** - mjet me motor, me dy, tre ose katër rrota.

**Gjysëm rimorkio -** mjet motorik i transportit i destinuar për transport pasagjerësh dhe mallrash.

**Makinë bujqësore** - mjet motorik me rrota ose me zinxhir i destinuar për t'u përdorur në bujqësi e pylltari, për transport të mallrave bujqësore.

**Motokarro** - mjete me tri rrota, të destinuar për transport malli. Mund të kenë deri në dy ndenjëse për njerëzit që merren me transportin, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit.

**Tërheqës-** Mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove.

**Autovetura për pasagjerë për 1.000 banorë -** Ky tregues llogaritet në bazë të stokut të automjeteve në 31 dhjetor për vitin referues dhe numrit të popullsisë në 1 janar të vitit pasardhës.

*Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT:* [http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3](http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/#tab3)